

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Investigimi i Fiks Fare/ “Nëse Bela çon emrin...”, Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtorëve për “shefen”
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/28/investigimi-i-fiks-fare-nese-bela-con-emrin-belinda-ba-lluku-ministre-edhe-pas-shkarkimit-deshmite-ekskluzive-te-drejtoreve-per-shefen1/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 21:20:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	28 shtator 2026, 18:50:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 28 shtator 2026, 18:49:00 UTC → 28 shtator 2026, 18:51:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	43b5711c30b21fa2cf28f552436af8172f082bbe850f4157f2d23093e08d6a6e
TEKSTI	f6da07c1e491668854f424a453e95e9461194d3701147159f6a431aa3ec398f0
PAMJA	84142d1276e259cc6d31afb8f843dc0438dbe0cba50cc2c472fe84925e7d20a0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c65e323d6984d6d86b6d8944a135604baf1c1953f0f0d95845f4dd16e9c149c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81d9502dee89498020984867f5c9e7803768541a0034d6fb041c0efcf168cb37
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4c65e323d6984d6d86b6d8944a135604baf1c1953f0f0d95845f4dd16e9c149c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET FIKS FARE KRYESORE TË FUNDIT

Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin...", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtorëve për "shefen"

28/09/2026 20:50



Fiks Fare hap sezonin me një investigim mbi pushtetin e Belinda Ballukut në Ministrinë e Infrastruktursë dhe Energjisë edhe pse është shkarkuar nga funksionet publike.

Në dokumente, ajo është shkarkuar. Në zyrë është vendosur një ministër tjetër. Por në institucionet që janë nën varësi të kësaj ministrie, drejtuesit flasin ndryshe.

Fiks Fare hyri në disa prej këtyre institucioneve, u prezantua si punëkëruese dhe bisedoi drejtpërdrejt me titullarët. Dhe në këto biseda, emri i Belinda Ballukut del përsëri në qendër: si "shefe", si person që mund të ndikojë në emërimet, në punësime dhe në vendimmarrje.

Nëse një ministre shkarkohet zyrtarisht, por drejtuesit e institucioneve vazhdojnë ta trajtojnë si autoritetin që duhet dëgjuar, atëherë pyetja është e pashmangshme: A është Belinda Balluku ish-ministre vetëm në letra, ndërsa në praktikë vazhdon të ushtrojë pushtetin e ministres?

Fiks Fare solli dëshmi, biseda dhe përballje direkte me Belinda Ballukun.

"Nëse Bela e çon emrin..."

Investigimi nis në Autoritetin e Aviacionit Civil, ku gazetarja e Fiks Fare kontaktonte drejtorin Maksim Et'hemaj, duke shprehur interes për një vend pune në sektorin e medias. Gjatë bisedës, Et'hemaj flet për punonjësen aktuale të medias dhe e lidh atë me Belinda Ballukun.

Sipas tij, nëse ajo do të zëvendësohej dhe në vend të saj do të vinte një person tjetër, kjo do të ishte thjesht çështje emrash, duke lënë të kuptohet se një propozim nga Balluku do të merrej në konsideratë. Por pse do të kishte rëndësi sot një emër i propozuar nga një ish-ministre?

"Nëse je mikesha e shefes, je dhe e imja"

Fiksi shkon më tej, në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial. Edhe këtu skenari është i njëjtë: kërkesë për punësim. Drejtori Sokol Zajmi shprehet: "Nëse je mikesha e shefes, je dhe e imja." Më pas ai përdor edhe një tjetër shprehje: "Ushtarët zëvendësohen kollaj, po mbretëresha nuk zëvendësohet dot." Por kush është "shefa" dhe kush është "mbretëresha"? Në kontekstin e bisedës së regjistruar nga Fiks Fare, referenca lidhet me Belinda Ballukun.

"Belinda Balluku e ka vënë Enea Karakaçin"

Investigimi vijon në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera. Gazetarja e Fiks Fare bisedon me drejtorin Rrapush Tola, sërish për mundësinë e

Kryesore



Nga CNN te CBS e The Times, mediat ndërkombëtare pyesin për Sazanin dhe Zvërnecin/ Si përgjigjet SPAK për dhëndrin e Trump

21:14

BE, një "surprizë" për Shqipërinë/ E zbulon "Politico", do ketë strategji më vete për 4 vendet që janë pranë anëtarësimit

21:50

Aksidentet u rriten këtë vit, tetëmuji me 983 aksidente, 6,2% më shumë se vjet; 1.378 të vrarë e të plagosur

20:07

Gjimshiti flet në prag të ndeshjes me San Marinon: Duket ndeshje e lehtë, por s'është e tillë, të jemi të përqendruar

19:24

Më të lexuarat

"Taulant Balla jam, më duhen 100 mijë euro", si tentuan dy të rinjtë të mashtronin Armand Dukën, agjenti i infiltruar iu prezantua si djali i kreut të FSHF

FOTOLAJM/ U shfaq për herë të parë në publik, kush është Elvis Lila, drejtuesi i SHISH i komanduar nga Rama

Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe arkivon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e vet, çështjet individuale të mos cenojnë besimin te shteti

Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin...", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtorëve për "shefen"

Fiks Fare/ "Belinda Balluku e ka vënë Enea Karakaçin". Drejtori i AKBN-së takime me ish-ministren deri në fund të gushtit: Do t'i çoj të fala

Detaje/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK

11 fëmijë, 7 gra, 3 Champions, 160 milionë të humbura, jeta e shfrenuar e Roberto Carlos

BE, një "surprizë" për Shqipërinë/ E zbulon "Politico", do ketë strategji më vete për 4 vendet që janë pranë anëtarësimit

"Kujdes!"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike

punësimi. Gjatë bisedës, Iola pretendon se Belinda Balluku ka vendosur Enea Karakaçin në krye të ministrisë dhe se një sinjal prej saj mund të ndikonte edhe në mundësinë e punësimit të gazetares. Një deklaratë që ngre një tjetër pikëpyetje: Nëse ministri aktual është në detyrë, përse një drejtues institucioni e lidh ende autoritetin e tij me ish-ministren?

Këshilltari i Ballukut ende në ministri

Fiksi vijon investigimin brenda vetë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës. Gazetarët kontaktojnë Flor Serjanin, ish-këshilltarin e Belinda Ballukut, i cili vijon të mbajë detyrë në ministri. Gjatë telefonatës, ai konfirmon se është ende në detyrë, ndërsa thotë se merret edhe me PR-in e Belinda Ballukut. Më pas, në një takim të zhvilluar në ambientet e ministrisë, Serjani flet për drejtuesit e agjencive në varësi të MIE-së. Sipas tij, drejtuesit janë vendosur me ndërhyrjen apo sugjerimin e Belinda Ballukut. Ai përmend edhe drejtuesin e AKBN-së, duke thënë se Balluku e ka sugjeruar atë. Por dëshmia shkon edhe më tej. Serjani tregon se është takuar me Belinda Ballukun vetëm dy ditë përpara bisedës me gazetaren e Fiks Fare.

Drejtori i AKBN-së: "Do t'i çoj të fala"

Pas kësaj dëshmie, Fiks Fare kontakton Genci Tërpon, drejtorin e AKBN-së. Tërpo konfirmon se ka takuar Belinda Ballukun në fund të muajit gusht. Gjatë bisedës, ai pranon t'i përcjellë të fala dhe shprehet se do të shohë situatën për mundësinë e punësimit të gazetares. Edhe një tjetër drejtues institucioni, pra, e lidh vendimarrjen me një person që zyrtarisht nuk e mban më postin e ministres.

Përballja me Belinda Ballukun

Pas gjithë këtyre dëshmive, Fiks Fare shkon te personi që përmendet vazhdimisht në këto biseda: Belinda Balluku.

Gazetarja e takon teksa ajo ecën në zonën e Liqenit të Tiranës.

Balluku fillimisht reagon ndaj mënyrës së ndjekjes dhe më pas i drejtohet edhe operatorit të Fiks Fare. Por pyetjes kryesore, pse drejtuesit e institucioneve vazhdojnë ta konsiderojnë atë "shefe", Balluku nuk i përgjigjet drejtpërdrejt.

Në vend të përgjigjes, ajo akuzon Fiks Fare për gjobëvënie dhe kritikon mënyrën e punës së gazetarëve. Teksa hyn në palestër, Balluku i drejtohet gazetares: "Mos u bëj gjobaxhie."

Belinda Balluku është larguar nga posti me letra por dëshmitë e drejtuesve që Fiks Fare kontaktoi ngrenë një pyetje shumë më të madhe: A është larguar ajo vetëm nga karrigia e ministres, apo edhe nga pushteti që lidhet me atë karrige?

Sepse nëse drejtuesit aktualë të institucioneve vazhdojnë ta konsiderojnë "shefe", nëse flasin për ndikimin e saj në emërime dhe punësime dhe nëse pranojnë se një sinjal prej saj mund të ndryshojë një vendim, atëherë kemi përballë një situatë që kërkon sqarim institucional.

A është Belinda Balluku ish-ministre vetëm në dokumente, ndërsa në praktikë vazhdon të ushtrojë funksione dhe ndikim si ministre? Dhe këtu lind edhe pyetja tjetër, tashmë për drejtësinë: Nëse këto dëshmi verifikohen dhe rezulton se një person i larguar zyrtarisht nga detyra vazhdon të ushtrojë funksione apo kompetenca shtetërore, a duhet SPAK të ndërmarrë hapat ligjorë që parashikon Kushtetuta, përfshirë edhe kërkimin pranë Kuvendit të autorizimit përkatës, nëse një autorizim i tillë kërkohet nga masa që synohet?

Sepse dokumentet mund të thonë se posti ka ndryshuar. Por dëshmitë e mbledhura nga Fiks Fare tregojnë që pushteti nuk ka ndryshuar.

Top Channel

I Aktualitet »



ngre alarmin për WhatsApp. PO komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni

Mesazhe me përmbajtje seksuale me nxënësen 13-vjeçare, arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnjë

Ekskluzive/ "Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit", zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama

28/09 23:00



Nga CNN te CBS e The Times, mediat ndërkombëtare pyesin për Sazanin dhe Zvermeçin/ Si përgjigjet SPAK për dhëndrin e Trump

28/09 21:14

Video/ "O hajdut", aktivistja i zë pritë Ulsi Manjës pasi del nga Komisioni i Ligjeve

28/09 22:26



Fiks Fare/ "Belinda Balluku e ka vënë Enea Karakaçin". Drejtori i AKBN-së takime me ish-ministren deri në fund të gushtit: Do t'i çoj të fala

28/09 20:49

Ngacmonte nxënësen 13-vjeçare/ Detaje të reja nga Lushnja, banorët për mësuesin 60-vjeçar: I vendosim duart në zjarr, ishte njeri i kulturuar

28/09 21:50



"Ushtarët zëvendësohen, mbretëresha jo"/ Fiks Fare brenda Institucioneve, drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Belinda Ballukun: Nëse je mikesha e shefes...


28/09 20:34

I Fiks Fare »



Fiks Fare/ "Belinda Balluku e ka vënë Enea Karakaçin". Drejtori i AKBN-së takime me ish-ministren deri në fund të gushtit: Do t'i çoj të fala

28/09 20:49



"Ushtarët zëvendësohen, mbretëresha jo"/ Fiks Fare brenda institucioneve, drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Belinda Ballukun: Nëse je mikesha e shefes...

28/09 20:34



Olta Gixhari dhe Dorian Ramaliu, dyshja e re në krye të "Fiks Fare"!

01/09 19:51



Fiks Fare/ Kulla vrojtimi pa vrojtues, vëzhgimi në plazhe zbulon shkelje të rënda të sigurisë

31/07 20:50



Fiks Fare/ "Mjeku më vendosi dy implante në një kockë që nuk i mbante", qytetarja: Kam paguar 1.200 euro, por nuk mora as trajtim e as paratë.

30/07 20:59



"Ta shëroj kancerin pa biopsi dhe pa kimioterapi"/ Fiks Fare zbulon "nutricionisten" që diagnostikon me bioskaner në dhomë hoteli dhe u premtonte pacientëve shërim

29/07 20:59

I Kryesore »



Ekskluzive/ "Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit", zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama

28/09 23:00



Liga e Kombeve, rezultatet e mbrëmjes/ Nga zhgënjimi te festivi i golave, Italia kthehet te fitorja, Franca marshon e qetë

28/09 22:54



Dosja e SPAK për SHISH/ "Përgjegjësi morale dhe individuale ka", Grida Duma: Po përgjegjësinë politike kush e mban?

28/09 22:44



Olise bëhet vendimtar, Franca e Zidane mposht Belgjikën në fund




Video/ "O hajdut", aktivistja i zë pritë Ulsi Manjës pasi del nga Komisioni i Ligjeve



"SPAK heton krimet e rënda, e ka kapur gafil zonjën"/ Karamuço debat me Kokën:

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ SHBA presion Serbisë, paralajmërimi i DASH pas bisedës Vuçiç-Putin



Top Channel/ Protesta ndryshon drejtim, marshim në Qytet Studenti: Bashkohuni!



Top Channel/ "Ne ushtarë, Bela mbretëreshë"! Investigimi i fortë i Fiks Fare



Top Channel/ Rusët përgjuan policitë europiane, të dhënat i çoi Kompania amerikane me pronarë rusë



Top Channel/ Vdekja e Mazonakis shkund Greqinë, probleme në qindra klinika private



Top News- 'Ushtarët zëvendësohen, mbretëresha jo'/ Investigimi i Fiks Fare: Belinda ende ministre!

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria